



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 63

Prishtinë, më 10.5.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Selvije Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj dhe Milena Miliqeviç.

**Munguan:** Albulena Haxhiu, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Sanije Berisha, Jeton Bytyçi dhe Bilbil Kastrati- OSBE; Norë Shabani, gazeta “Koha ditore”; Florije Kika, KPA; Lumnije Murati, ZPRK; Shefki Kastrati, NDI; Arlinda Bajrami, Instituti GAP; Lekë Batalli, GLPS; Albert Krasniqi dhe Artan Murati, KDI; Kenan Gashi dhe Shkëndije Hashani, Avonet; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Besim Morina dhe Suzana Pllana, IGJK dhe Shaip Muja, deputet.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2015;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës;

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-050 për Kinematografinë;
7. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua me ndryshime, për të shqyrtuar Raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-085 për Energjinë elektrike dhe një amendament nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision kryesor për Projektligjin nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.*

## **2. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2015**

**Kryesuesja** ftoi ushtruesen e detyrës së zëvendës drejtorit ekzekutiv të Agjencisë, znj. Florije Kika, të marrë fjalën.

**Florije Kika**, duke folur për Agjencinë, tha se kjo Agjenci është e pavarur, e cila është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10, më pas e ndryshuar 2006/50 dhe Ligjin 03/L-079. Mandati i Agjencisë është që të zgjidhë kërkesat për të drejtën pronësore dhe të shfrytëzimit me të drejtë ankese në Gjykatë Supreme të Republikës së Kosovës, për pronat e paluajtshme private që përfshihen rrethanat e ndërlidhura me luftën që kanë ndodhur ndërmjet periudhës 27.2. 1998 - 20.6.1999. Gjithsej, Agjencia ka pranuar 42.749 kërkesa dhe të gjitha këto kërkesa janë zgjidhur në fund të dhjetorit 2014. Ndërsa, në fillim të janarit 2015, janë përpiluar të gjitha vendimet individuale dhe janë përfunduar të gjitha kërkesat, sa i përket vendosjes dhe përfundimit të tyre. Komisioni për të drejta pronësore ka vendosur në 41.849 kërkesa, ndërsa sekretaria ekzekutive ka hedhur poshtë 267 kërkesa, që gjithsej japin nr. 42.116 kërkesa, të vendosura nga komisioni dhe nga sekretaria ekzekutive. Kurse 633 kërkesa janë tërhequr me kërkesën e palës, pa iu dorëzuar komisionit për vendimmarrje. Gjatë vitit 2015, Agjencia është fokusuar në zbatimin e këtyre vendimeve dhe 6235 janë zbatuar. Sipas legjisllacionit në fuqi, të gjitha vendimet e plotfuqishme, me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, ato duhet të zbatohen dhe këto kërkesa janë për administrim të pronës, kërkesa për riposedim dhe kërkesa për mbyllje, dhe gjatë vitit 2015, 534 prona të reja janë marrë nën administrimin e Agjencisë, që e bie numrin në 13.026 prona të cilat administrohen nga Agjencia, që një pjesë e tyre është transferuar nga mandati i Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore, pasi sipas legjisllacionit në fuqi, kjo kompetencë i ka kaluar Agjencisë. Përveç kësaj, Agjencia ka vazhduar me administrimin e skemës së qirasë, ku gjatë vitit të kaluar 543.638.83 € janë mbledhur nga qiraja dhe nga kjo shumë 432.676.98 €, u janë bartur bartësvetë identifikuar të së drejtës pronësore. Znj. Kika sqaroi se gjatë vitit të kaluar janë planifikuar 2532 dëbime, ndërsa nga këto 945 dëbime fizike janë ndërmarrë nga njësia e dëbimeve me mbështetjen e policisë, 114 kanë qenë për riposedim të pronës, 625 për riuzurpime të paligjshme dhe 126 për mospagimin e qirasë, ku 80 të tjera për refuzim për të hyrë në marrëveshje të qirasë.

Ndërsa, Bordi Mbikëqyrës, është kompetent për mbikëqyrjen e punës së Agjencisë, të hartojë politika të ndryshme, dhe assesit të mos ndikojë në vendosjen e kërkesave gjatë shqyrtimit të Komisionit.

Si sfida të Agjencisë, janë mungesa e drejtorit dhe e zëvendës drejtorit. Një tjetër sfidë, del të jetë qëndrueshmëria financiare, sidomos ajo që vjen nga donatorët dhe kjo ka bërë që një pjesë e stafit, duke përfshirë dhe atë profesional, të largohet nga Agjencia. Sfidë tjetër mbetet skema e

kompensimit të qirasë, që janë raste të trashëguara nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore . Për këto raste, nevojiteshin 3.200.000 €. Zbatimi i vendimeve paraqitet si një sfidë tjetër e Agjencisë, sidomos kur vjen në shprehje është veriu i vendit, respektivisht veriu i Mitrovicës, ku znj. Kika sqaroi se 835 dëbime kanë mbetur pezull dhe prej tyre, vetëm në veri të Mitrovicës, janë 242 dëbime pezull. Mosmiratimi i Ligjit të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, paraqet një sfidë tjetër për punën e këtij institucioni.

**Selvije Halimi**, ngriti shqetësim se përse nuk është proceduar ende zgjedhja e drejtorit të kësaj Agjencie.

**Armend Zemaj**, në fjalën e tij, sqaroi se edhe Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, është në procedura të miratimit. Më pas, parashtrroi disa pyetje: Cili është relacioni i Agjencisë me gjykatat, sa i përket uzurpimeve dhe riuzurpimeve? Sa kallëzime penale janë bërë? Si po menaxhohet Fondi i mirëbesimit? Çka veçohet si sukses i Agjencisë për vitin 2015?

**Agim Aliu**, në fjalën e tij, tha se është për t'u vlerësuar puna që e ka bërë Agjencia, për faktin se duhet të kemi parasysh se pronat çdo kund në shtetet e lindura nga sistemet e së kaluarës, kanë qenë sfidë dhe aq më tepër për Kosovën, që kemi pasur një tranzicion të dyfishtë: atë ideologjik dhe atë të luftës. Agjencia duhet të shtrihet në shtatë rajone dhe jo në pesë siç është, sepse duhet të shtohen zyra për Ferizaj dhe zyra për Gjakovë. Z. Aliu pyeti: Kur përmenden dëbimet, do të doja të dija, sa janë trajtuar në aspektin human një pjesë e tyre, duke pasur parasysh gjendjen sociale dhe sa kallëzime penale janë bërë?

**Milena Miliqeviç**, në fjalën e saj, tha se si do të vazhdohet mbrojtja e pronave dhe uzurpimi i tyre, sepse nuk është problem i Agjencisë, por me shumë është problem i vendimeve të gjykatës. Uzurpimi po vazhdon të jetë në nivel të ngritur dhe cila do të jetë mënyra që me ligj të parandalohet uzurpimi i pronës?

**Florije Kika**, duke iu përgjigjur në shqetësimet nga ana e kryesueses së Komisionit, në lidhje me ushtrimin e funksionit të saj, ajo theksoi se një e gjë e tillë, pra funksioni i mandatit, si ushtruese e detyrës, më shumë sesa është e lejuar me ligj, ka ndodhur, sepse nuk ka pasur propozime nga Qeveria, edhe pse një gjë e tillë është kërkuar në vazhdimësi nga ne. Sa i përket riuzurpimeve, arsytet pse ne i kemi këto probleme, është se Agjencia pasi e kryen dëbimin e parë, dhe pas 72 orëve, nëse kjo pronë sërish është e uzurpuar, e kryen dëbimin e dytë, ku e së bashku me policinë bën monitorimin e kësaj prone, nëse kjo uzurpohet prapë. Ne, si Agjenci, jemi të detyruar të bëjmë kallëzime penale, dhe në bazë të Kodit Penal, nëse kësaj prone i thyhet dryni. Në raportin e vitit 2015, kemi vetëm 14 raste të iniciuara në Prokurori, ndërsa vetëm një është zgjidhur. Sa i përket Fondit të mirëbesimit, çdo gjë shkon përmes Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Thesarit, ndërsa si Agjenci, vetëm i zbatojmë procedurat. Ne administrojmë disa prona, të cilave nuk iu dihet pronari, kurse ajo shumë është e mbledhur në buxhetin e Kosovës. Gjithashtu, 5 % -shin nuk e menaxhon Agjencia, por ato, po ashtu derdhen në Buxhetin e Kosovës. Sa i përket pyetjes së trajtimit, human znj. Kika përmendi bashkëpunimin me komunat, ku Komuna e Gjakovës dhe ajo e Mitrovicës, kanë një fond të caktuar për çështje sociale dhe shpeshherë arrijnë marrëveshje të qirasë përmes nesh, për ato familje që nuk i kanë kushtet sociale. Në projektligj jemi munduar që këto riuzurpime, pas dëbimit të dytë nga Agjencia, që të gjitha palët të kenë të drejtën ta adresojnë këtë çështje, në procedurën përmbartimore.

*Pas diskutimeve Komisioni vendosi që Kuvendit të i'a paraqes këtë :*

### **Rekomandim**

Të miratohet Raporti i punës së Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2015

### **3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2015**

**Selviqe Halimi**, ngriti shqetësimin në bazë të raportit, sa i përket vështirësive që është hasur në bazën ligjore, për shkak të plotësim-ndryshimeve të ligjeve për Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe Ligjit për gjykatat dhe tha se ne i jemi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me një rekomandim, për t'u bërë konsolidimi i këtyre ligjeve.

**Besim Morina**, në fjalën e tij, foli për mandatin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, e që ka të bëjë me trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë të Kosovës. Raporti i punës për vitin 2015, përfshinë trajnimin e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë, që janë organizuar në të gjitha degët e së drejtës, e veçanërisht: penale, civile, përfshirë drejtësinë për fëmijë, administrative, kushtetuese, tregtare, të drejtën ndërkombëtare, të drejtën e Bashkimit Evropian, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut etj. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë përfshirë edhe tema e module trajnuese të karakterit disiplinor, si etika profesionale, arsyetimi ligjor, menaxhimi etj. Në mbështetje të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar, IGJK-ja ka përgatitur programe orientuese, të fokusuara në informimin e strukturës organizative në gjykata dhe prokurori, si dhe adaptimin në ushtrimin e gjyqarit/prokurorit. Z. Morina tha se në prill të vitit 2015, përfundoi me sukses trajnimi fillestar i gjeneratës së pestë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Në periudhën raportuese, 28 (njëzet e tetë) kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë, kanë përfunduar fazën praktike të Programit për Trajnim Fillestar, si dhe i janë nënshtruar provimit përfundimtar. Po ashtu, gjatë periudhës raportuese, IGJK-ja ka organizuar trajnime për stafin mbështetës të gjykatave dhe prokurorive, ndërsa është punuar, në mënyrë intensive, edhe në fushën e publikimeve, me ç' rast janë publikuar një seri e moduleve në të gjitha programet trajnuese, si dhe doracakë për gjyqtarë, revista shkencore, buletine e broshura. Më tej, z. Morina tha se është punuar në ofrimin e punimeve ligjore për gjyqtarë dhe prokurorë, ku është themeluar biblioteka ligjore, që përbëhet nga materiale në kopje fizike dhe elektronike, përfshirë abonime në databaza ligjore ndërkombëtare. Gjithashtu, janë realizuar aktivitete të ndryshme, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe është shënuar pjesëmarrje aktive në konferenca e takime rajonale, që kishin në fokus trajnimin për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë nga lëmi i gjyqësisë. IGJK ka vazhduar, në mënyrë intensive, bashkëpunimin me donatorë dhe partnerë zbatues të programeve të ndryshme të trajnimit, ku disa prej projekteve kanë qenë afatmesme dhe janë vazhdimësi edhe në vitet në vijim. Për vitin 2015, baza ligjore ka pasur ndryshime ligjore në Ligjin për gjykatat, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Bazuar në këto ligje, provimi për gjyqtarë/prokurorë, i cili deri në këtë kohë është organizuar nga IGJK-ja, tani e tutje do të organizohet nga KGJK dhe KPK, si dhe trajnimi fillestar do të ndiqet pas emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këto ndryshime kanë ndikim drejtpërdrejt në mandatin e IGJK-së, përcaktohet se provimi përgatitor organizohet nga IGJK-ja, në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në,

ndërsa trajnimi fillestar ndiqet nga kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, para emërimit. Vështirësitë ligjore, që ka hasur IGJK-ja në përmbushjen e misionit të vet, është se IGJK-ja është e lidhur ngushtë me zbatimin e Ligjit për gjykatat, Ligjit për Prokurorinë e Shtetit, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Në këtë drejtim, për IGJK-në janë paraqitur disa vështirësi. Së pari, për faktin se këto ligje nuk kanë qenë në harmoni me Ligjin për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, e veçanërisht në pjesën e kompetencave që burojnë nga këto ligje. Konkretisht, kjo është reflektuar tek organizimi i provimit përgatitor për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë. Pastaj, ai tha se përveç kësaj, është edhe mosharmonizimi i vetë Ligjit për gjykatat dhe Ligjit për Prokurorinë e Shtetit, deri në amendamentimin e tyre në qershor 2015, posaçërisht lidhur me kriteret për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka krijuar disa vështirësi për IGJK-në dhe zbatimin e Programit për Trajtim Fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë.

**Armend Zemaj**, në fjalën e tij e vlerësoi raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe pyeti se kush janë trajnuesit dhe a ka vlerësime për trajnuesit, sepse ngarkesa e tyre në punë nuk ka dhënë shumë rezultate në gjyqësor.

**Nezir Çoçaj**, në fjalën e tij, e vlerësoi raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe pyeti: A ka kërkuar ndonjë agjenci nga ju, për të mbajtur trajnime?

**Agim Aliu**, në fjalën e tij, e vlerësoi raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Sa i përket sfidave që ju i përmendët, që kanë të bëjnë me ligjet, kanë qenë sfida edhe të komisionit për Legjislacion. Pse është fondi i titujve kaq i ulët në gjuhën shqipe?

**Besim Morina**, duke iu përgjigjur pyetjeve, tha se kemi pasur kërkesë për organizim të trajnimeve prej një institucioni, përgjigjja ka qenë pozitive, dhe në secilin rast që ka kërkesa të tilla, përgjigjja është pozitive. Kur është përcaktuar lista e librave që duhet të blihen, është bërë nga ekspertët e fushës, ndërsa para se të bëhet kjo listë, ju kemi drejtuar të gjitha shtypshkronjave dhe shtëpive botuese dhe kemi kërkuar që të marrim tituj të ndryshëm të librave. Të gjithë librat janë në bibliotekën e Institutit Gjyqësor të Kosovës, me përjashtim të bibliotekës elektronike, për faktin se nuk ka shumë libra që ne mund t'i përdorim. Ai, po ashtu, sqaroi se në formë elektronike, kryesisht dominojnë tituj në gjuhë angleze, sepse ato mund të gjinden më lehtë dhe databaza ligjore, që Instituti është abonuar, nuk ofron materiale në gjuhën shqipe, por vetëm në gjuhën angleze.

*Pas diskutimeve Komisioni vendosi që Kuvendit të i'a paraqes këtë :*

### **Rekomandim**

Të miratohet raporti i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2015

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës**

**Kryesuesja**, në fjalën e saj, tha se projektligji është dërguar në komisionet kryesore, ku janë kaluar të gjitha afatet për shqyrtim. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka dërguar një propozim teknik, ku ne si komision mendojmë ta aprovojmë. Neni 27 i projektligjit, që ka të bëjë me buxhetin e Agjencisë, ndryshohet si vijon: Amendamenti 1: “Agjencia përgatit dhe menaxhon buxhetin në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin financave publike dhe përgjegjësitë. Kurse Komisioni për Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në afatin e përcaktuar sipas rregullores së punës së Kuvendit nuk e ka shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e propozuara. Andaj meqënëse ka kaluar afati sipas rregullores i njëjti procedohet për Kuvend pa raportin e Komisionit për Komunitete.

*Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash ( pesë vota **për** dhe një **kundër**)Kuvendit vendosi të i'a paraqes këtë:*

#### **R e k o m a n d i m**

- I. Të Miratohet Projektligji nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me amendamentet e propozuara.

#### **5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës**

**Kryesuesja**, Paraqiti raportin me amendamente të projektligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës dhe tha se ky projektligj është krijuar të bëjë lehtësira, sa i përket investimeve strategjike të të interesuarve, qoftë të jashtëm apo të brendshëm, në Kosovë. Më tej znj. Halimi paraqiti shqetësim në nenin 5 paragrafi 5 i këtij projektligji duke cituar “ *Qeveria e Republikës së Kosovës mund të hyjë në negociata të drejtpërdrejta me subjektet investuese për lidhjen e marrëveshjeve për investime strategjike pa ju nënshtruar procedurave për marrjen e statusit investimet strategjike dhe procedurave të prokurimit publik, nëse një gjë e tillë është e paraparë në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare në mes Republikës së Kosovës dhe një ose më shumë shteteve tjera apo organizatave ndërkombëtare. Ne e kemi të qartë që marrëveshjet ndërkombëtare janë edhe mbi ligjin. Znj. Halimi kërkoi sqarim sa i përket nenit 5 paragrafit 5 dhe amendamentit 8 sepse po krijohet mundësia që të përjashtohen procedurat e prokurimit. Në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare investimet e huaja që bëhen në Kosovë duhet të zhvillohen sipas ligjeve të Kosovës.*

**Armend Zemaj-** Kërkoi të sqarohet se kur caktohet ose përjashtohen elemente të caktuara të prokurimit sepse këtu nuk flet për ligjin por për dispozita të caktuara që kanë bëjnë me investimet e huaja.

*Meqë kishte vërejtje , Kryesuesja konstatoi se komisioni me shumicë votash (pesë vota **për** dhe një votë **abstenim**) vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:*

## Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç nenit 5 të projektligjit.
2. Të harmonizohet neni 5 i projektligjit me dispozitat e Ligjit për prokurimin publik.

### **6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-050 për Kinematografinë**

**Kryesuesja**, në fjalën e saj, tha se po shqyrtojmë raportin me amendamente të Komisionit funksional nr. 05/L-050 për Kinematografinë, duke ftuar të marrë fjalën deputeti, z. Shaip Muja dhe të paraqesë shqetësimet e tij.

**Shaip Muja**, në fjalën e tij, paraqiti shqetësime lidhur me këtë projektligj, duke thënë se ka disa kufizime që shkelen edhe me parimet e Acque Communitare, që janë me standardet e Bashkimit Evropian. Mbi të gjitha, kinematografinë e izolojnë nga të qenurit bashkëpjesëmarrës të bashkimit ndërkombëtarë të financimit të filmave dhe të prodhimit vendor. Kryesisht, ka vërejtje në nenin 3, në nenin 14, që ka të bëjë me zgjedhjen e drejtorit, i cili është në kundërshtim edhe me të drejtat e njeriut dhe mundësit e lënies së abuzimit për zgjedhjen e tij. Po ashtu, mënyra e kufizimit, ku një drejtor nuk lejohet të marrë pjesë, nëse nuk e ka një projekt të kryer dhe projekti i kryer është ai që financohet nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport. “Anëtarët e jurisë duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës”, thuhet në nenin 28 dhe mendoj se është shumë kryciale. Juria mund të jetë edhe me pjesëmarrës ndërkombëtarë. Duhet të jetë në ligj edhe me pjesëmarrës ndërkombëtarë. Ne nuk mund të pretendojmë se jemi në Hollywood dhe të mos lejojmë anëtarë të jurisë ndërkombëtare, tha më tej z. Muja. Sipas tij, çdo person që është nga rajoni mund të marrë pjesë në vlerësimin e projekteve filmikë që financon shteti, dhe nëse e kufizojmë vetëm në vendorë, mendoj që po çojmë në një lloj izolimi. Rajoni ka jashtëzakonisht shumë artistë. Ne duhet të lirohemi nga komplekset. Edhe ne kemi artistë, por kemi nostalgjikë. Ne me filmin “Shok” u mburrëm të gjithë. Sikurse të mos kishte qenë ndërhyrja ndërkombëtare dhe ato lidhjet e lotimeve, sot, “Shok” nuk do të kishte mbërritur në Hollywood.

**Kryesuesja**, më tej, sqaroi duke thënë se të gjitha shqetësimet e juaja, ne i kemi marrë edhe nga komuniteti, por këto shqetësime që ju i paraqitët, duhet t’i trajtojë Komisioni funksional, sepse ne për këtë projektligj jemi komision kryesor dhe e shqyrtojmë vetëm kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e këtij projektligji, se a është në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

**Armend Zemaj**, në fjalën e tij, tha se kam vërejtje sa i përket “Kosova Filmit”. Sipas këtij projektligji, ish- shtëpia për prodhimin e filmave, transformohet në Arkiv të Filmit, përderisa pronat e “Kosova Filmit” do të kalojnë në pronësi të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Transformimi i pronës dhe i pasurisë nuk mund të rregullohet me një akt. Këtu, nuk po flasim për themelim të ri. Mendoj se kjo duhet rishikohet në detaje, tek Komisioni funksional dhe tek sponsori. Sepse, me një amendament të bartet prona te Kuvendi i Republikës së Kosovës, unë nuk e di sesi do të rregullohet dhe cila është përgjegjësia tani e tutje, duke shtuar se prona nuk mund të bartet nëpërmjet një amendamenti. Po ashtu, z. Zemaj ka shtuar se askush nuk mund të shuajë veprimtarinë 40 vjeçare të “Kosova Filmit”. Ne do të diskutojmë edhe në Kuvend dhe ky

ligj duhet t'i kthehet Qeverisë për ripunim, për të cilin është pajtuar edhe deputeti, z. Shaip Muja.

*Meqë kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

Të rishikohet raporti me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-050 për Kinematografinë.

## **7. Të ndryshme**

### **A. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-085 për Energjinë elektrike**

**Kryesuesja** paraqiti raportin me amendamente të Komisionit funksional për projektligjin nr. 05/L-085 për Energjinë elektrike.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 05/L-085 për Energjinë elektrike dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

1. Projektligji dhe amendamentet e propozuara, mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës, të jetë më 24.5.2016, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Fatbardha BOLETINI

Nënkryetarja e Komisionit,

---

**Selvije Halimi**